



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 4592 Prot.

Shkodër, më 24.02.2025

**RAPORT MBI PUNËN E KËSHILLIT TË BASHKISË PËR 12 - MUJORIN E VITIT
2024**

Të nderuar këshilltarë !

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të Bashkisë.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloret e miratuara nga vet Këshilli.

Më poshtë po paraqesim disa nga aktivitetet e Këshillit Bashkiak Shkodër për vitin 2024:

Vendimmarrja

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar disa mbledhje komisionesh me një pjesëmarrje të ulët të këshilltarëve. Numri më i madh i mbledhjeve të komisioneve është ai i komisioneve të përhershme si: Komisioni i Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike, Komisioni i Shërbimeve Sociale dhe Strehimit, Komisioni për Çështjet Ligjore, Komisioni i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Rendit Publik dhe Mbrojtja Civile.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2024, janë mbajtur 9 Mbledhje të Këshillit Bashkiak, në të cilat janë miratuar 76 vendime gjithsej, për të cilat Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër është shprehur pozitivisht për ligjshmërinë e tyre. Nuk ka patur asnjë akt të kthyer nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër. Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që kanë të bëjnë me projekte prioritare të Bashkisë, projekte të bashkëpunimit të Bashkisë me Ministrinë e linjës etj.

Mund të përmendim si vendime kryesore gjatë vitit të kaluar si:

1. Miratimi i Buxhetit të Bashkisë.
2. Miratimi i Programeve të Shërbimit Social.

3. Miratimi i Planeve të ndryshme, si : Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane, Plani Vendor i Veprimit për Energji dhe Klimë etj.

Mbledhjet e Këshillit Bashkiak frekuentohen mesatarisht nga 40 këshilltarë për çdo mbledhje. Disa këshilltarë nuk janë gjithmonë të pranishëm në mbledhje, duke mos respektuar kështu vullnetin dhe besimin e qytetarëve që i kanë zgjedhur.

Përsa i përket mbledhjeve të komisioneve të përhershme të Këshillit, duhet thënë se ato nuk zhvillohen rregullisht për mungesë kourumi, duke krijuar kështu probleme në mbarëvajtjen e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Mospjesëmarrja në komisione sjell diskutime të pafundme dhe të tepërta mbi secilin nga projektvendimet e paraqitura për tu miratuar. Në mbledhjet e komisioneve këshilltarët mund të njihen me detaje për çdo projektvendim të paraqitur dhe mund të kërkojnë sqarime nga stafi i Bashkisë dhe gjithashtu të bëjnë propozime për përmirësimin e projekt aktit. Nëse këto diskutime nuk zhvillohen siç duhet në komisione, ato shtrihen në mbledhjet e Këshillit, duke i zgjatur ato pa nevojë dhe duke e bërë të vështirë informimin e qytetarëve mbi çështjet që trajtohen.

I gjithë dokumentacioni projektvendimeve të shqyrtuara dhe vendimeve të marra gjatë mbledhjeve të Këshillit është publikuar në faqen zyrtare web të Këshillit për t'i ofruar qytetarëve mundësinë të kenë qasje dhe të informohen për to. Në regjistrin online për transparencën e mbledhjeve të Këshillit, janë të dokumentuara të gjitha informacionet e nevojshme, duke përfshirë thirrjen për mbledhje, oraret e mbajtjes, videot e mbledhjes dhe procesverbalet përkatëse. Mbledhjet e Këshillit janë transmetuar online në faqen e Facebook-ut të Këshillit Bashkiak dhe në mediat vendore. Kjo i ofron Këshillit Bashkiak pavarësi në transmetimin e pandërprerë të mbledhjeve në formën e livestream, duke krijuar mundësinë për transparencë të plotë në lidhje me të gjitha vendimet që miraton dhe çështjet që trajton, për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve dhe për t'i mbajtur ata të informuar.

Kërkesat dhe ankesat e qytetarëve

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024, në Këshillin Bashkiak Shkodër janë regjistruar 24 kërkesa, të cilat janë trajtuar në mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe përmes shkresave zyrtare. Pjesa më e madhe e kërkesave ka qenë për emërtime rrugësh, kërkesa për informacion, kërkesa për tituj nderi, ndërhyrje në infrastrukturë, etj. Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur peticione ose nisma të qytetarëve të depozituara në Këshill.

Këshilli Bashkiak, në koordinim me Bashkinë, angazhohet për t'u dhënë përgjigje të gjitha shqetësimeve të qytetarëve, brenda mundësive dhe kornizës ligjore. Kërkesat dhe ankesat janë të dokumentuara dhe të publikuara në regjistrin online të kërkesave dhe ankesave në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak.

Konsultimi me publikun

Këshilli Bashkiak i ka kushtuar vëmendje të veçantë dëgjësive publike për projektaktet, për të cilat kërkohet nga ligji. Janë zhvilluar 8 konsultime publike për 5 projektakte.

Në dëgjesa morën pjesë gjithsej 626 qytetarë, ndër këto qytetarë, biznese, grupe interesi dhe anëtar këshilli. Të gjitha informacionet për konsultimet me publikun janë të publikuara në regjistrin online për konsultimet me publikun në faqen web të Këshillit Bashkiak.

Kryesisht kërkesat e qytetarëve janë mbi: Përmirësimin e infrastrukturës së shkollave, kopshteve dhe çerdheve, përmirësimin e infrastrukturës rrugore, përmirësimin e shërbimeve publike ujësjellës - kanalizime, menaxhimi i mbetjeve, zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, pastrimi i kanaleve kulluese dhe vaditëse, shtimin e hapësirave rekreative për të rinjtë, përmirësimi i transportit urban dhe lidhja e tij me rrjetin rural, shërbimet në favor të bizneseve që punojnë për turizmin etj. Numri i rekomandimeve të dala nga këto takime është 516, prej të cilave 67 % e tyre janë reflektuar në vendimet e marra nga Këshilli.

Më poshtë lista e dëgjesave të mbajtura:

Nr	Titulli i projektvendimit	Nr. seancave	Nr. Pjesëmarrësve	Nr. Rekomandimeve
1.	Për draft projekt planin buxhetor afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Shkodër.	12	488	462
2.	Caktimi i zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe, në territorin e Bashkisë Shkodër.	1	14	0
3.	Për miratimin e planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane, Bashkia Shkodër 2024.	1	12	2
4.	Për miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit të Arsimit Parashkollor në Bashkinë Shkodër.	1	59	37
5.	Për miratimin e planit vendor të mbrojtjes së Biodiversitetit.	1	9	0
6.	Miratimi i rregullores për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për vendosjen e veprave të artit në territorin e Bashkisë Shkodër.	1	13	9
7.	Për miratimin e Planit vendor të veprimit për energji dhe klimë.	1	22	2
8.	Për kriteret dhe procedurat e dhënies së titujve vendor të nderit dhe vendosjes së emërtesave të rrugëve , shesheve,	1	9	4

	territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Shkodër.			
--	--	--	--	--

Aktivitetet kryesore të Këshillit

Gjatë vitit 2024 në bashkëpunim me Projektin Bashki të Forta janë realizuar 2 trajnime 2 ditore për këshilltarët në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak.

Këshilli Bashkiak Shkodër për aktivitetet e vitit 2024 ka shpenzuar 47% të buxhetit të planifikuar. Pjesa më e madhe e buxhetit është shpenzuar, për mbajtjen e dëgjësive publike për projekt akte të ndryshme, shpenzime për trajnimin e këshilltareve në bashkëpunim me Projektin Bashki të Forta, shpenzime për kancelari dhe shpenzime të tjera për mbarëvajtjen e aktiviteteve të Këshillit Bashkiak. Janë realizuar dy vizita studimore: 1. Vizitë studimore në Lozanjë, Zvicër . 2. Vizitë për mundësi binjakëzimi në komunën e San Giorgio a Cremano.

Nga këto shpenzime janë të përjashtuara shpenzimet për honoraret e këshilltarëve.

Këshilli Bashkiak ka miratuar planin e Aktiviteteve, Vendimmarrjes dhe Konsultimeve për vitin 2025 të shoqëruar me një buxhet 20 531 (mijë lekë.)

Këshilli Bashkiak komunikon në mënyrë të vazhdueshme me qytetarët përmes rrjeteve sociale të tij për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, duke i ftuar qytetarët të bëhen pjesë aktive në dialogun me qeverisjen vendore, të përdorin instrumentet e Këshillit për zgjidhur problemet e tyre dhe për t'i kërkuar llogari apo të zgjidhin problemet e tyre nëpërmjet kërkesë/ankesave që mund të drejtojnë te Këshilli, mund të ndjekin mbledhjet online apo të marrin pjesë në dëgjësat publike për projekt akte të ndryshme apo për buxhetin e Bashkisë.

SEKRETARE

SABINA DANAJ


